

**Referenca e kushteve Kërkesë për oferta për:
“Moderator për Takimet Ndërgjegjësuese”**

Shoqata "Unë, Gruaja"

Lloji i kontratës:	OFRUES I SHËRBIMIT – Moderator për Takime Ndërgjegjësuese – Projekti “Aktorët lokalë dhe ndërkufitarë punojnë së bashku në mbrojtjen e mjedisit të rajonit Prespë-Ohër.”
Fondi në dispozicion	200 EUR/takim

Data e shpalljes:	12.02.2024
Afati për aplikim	23.02.2024

Informacione të përgjithshme për “Unë, Gruaja”

“Unë, Gruaja” është një organizatë jofitimprurëse, jopolitike, jofetare, e cila është regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar, si shoqatë vendase në vitin 2003. Shoqata ka kontribuar për përmirësimin e barazisë politike dhe sociale mes burrave dhe grave.

Aktivitetet e shoqatës “Unë, Gruaja” përfshijnë: shërbimet e këshillimit; trajnime; ndërgjegjësimin e publikut; shpërndarja e informacionit; pjesëmarrja e grave në vendimmarrjen lokale; monitorimi i vendimeve të pushtetit vendor nga këndvështrimi gjinor; avokimi dhe lobimi në nivel lokal dhe kombëtar; dëgjesa publike; karvane mjedisore; karvane portokalli; etj.

Qëllimi i Shërbimit

Shoqata "Unë, Gruaja" Pogradec (UG) ka filluar zbatimin e projektit "Aktorët lokalë dhe ndërkufitarë punojnë së bashku në mbrojtjen e mjedisit të rajonit Prespë-Ohër", i cili ka për qëllim kryesor të forcojë kapacitetet e komunitetit në rajon rreth mbrojtjes së biodiversitetit përmes shkëmbimit të praktikave më të mira dhe njohurive ndërmjet aktorëve në të gjithë Rajonin Lokal të Ohrit (LOR).

Gjatë zbatimit të projektit, anëtarë të LAG, të cilët janë trajnuar dhe me përvojë, do të organizojnë takime ndërgjegjësuese me grupet e interesit dhe komunitetin për të zgjeruar njohuritë/informacionet në lidhje me çështjet e Biodiversitetit dhe Mjedisit. Së pari, ata do të identifikojnë një zonë specifike për të inicuar diskutime me komunitetin rreth rëndësisë së burimeve natyrore dhe eksplorimit të përfitimeve. Pyetjet

kryesore udhëzuese për të filluar diskutimin do të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: Çfarë janë dhe sa të rralla janë speciet që gjenden këtu? Cilat burime po përdoren aktualisht nga komuniteti? A është i mundur ekoturizmi? A janë metodat e bujqësisë organike një opsion në këtë fushë? Çfarë përfitimesh mund të përfitohen nga ruajtja e komunitetit, kush është i interesuar të mësojë më shumë? Kush mund të përfitojë më shumë nga këto veprime? etj.

Në këto takime, komuniteti do të njihet edhe me rezultatet e pyetësorit, si dhe do të shpërndahen prioritetet e nxjerra nga takimet e mëparshme. Do të shkruhen artikuj për pikat e nxehta dhe zgjidhjet e sugjeruara nga LAG. Raportet e hartuara pas takimeve do të diskutohen me ekspertin e avokatisë për të shqyrtuar draftin e avokimit.

Ekspertët do të angazhohen për të organizuar dhe moderuar 12 takime me komunitetin në vit.

Takimet janë planifikuar të zhvillohen gjatë periudhës 1 Mars-15 Prill 2024.

Moderatori do të angazhohet për numrin e takimeve që do të realizojë sipas ekspertizës që ofron, sipas kalendarit të aktiviteteve.

Rolet dhe përgjegjësitë që ekspertët duhet të përmbushin:

- Përcakton fushat për diskutim në bashkëpunim me UG
- Siguron realizimin e takimeve me komunitetin me rreth 15 pjesëmarrës për takim
- Moderon takimet dhe diskuton me pjesëmarrësit
- Inkurajon pjesëmarrësit të dalin me ide për zgjidhjen e problemeve rreth Biodiversitetit
- Ofron mbështetje dhe i referohet problemeve që mund të lindin pranë UG
- Është përgjegjës për përgatitjen e raportit me gjetjet dhe rekomandimet nga takimet. (Temat e trajtuara, gjetjet dhe çështjet specifike të diskutuara, fotot, etj.)
- Është përgjegjës për përgatitjen e një artikulli/ materiali për tu publikuar në rrjetet sociale, në lidhje me temën/çështjen më sensitive të takimit
- Të ketë aftësi për të ndërtuar marrëdhënie efektive pune me pjesëmarrësit, për të lehtësuar dialogun dhe mirëkuptimin ndërmjet grupit.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

Kërkohet eksperiencë për ekspertin

- Njohuri mbi çështjet mjedisore dhe Biodiversitetin.
- Të paktën 5 vjet përvojë pune përkatëse në shoqërinë civile me fokus të veçantë në mjedis, ndërgjegjësimin, informimin dhe pjesëmarrjen e publikut.
- Aftësi të forta komunikimi dhe aftësi për të ndikuar tek të tjerët.
- Aftësi të demonstruara planifikuese dhe organizative;
- Aftësi efektive për zgjidhjen e problemeve

Procedura e aplikimit:

Kjo thirrje hapet në fillim për anëtarët e LAG, nëse nuk ka aplikime apo nuk realizohen 12 aktivitetet e planifikuara, thirrja do të jetë publike.

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

Curriculum Vitae

Letër interesi ku të përfshihet edhe Oferta Financiare

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data 23 Shkurt 2024.

Aplikimi mund të dorëzohet:

me e-mail në adresën: une_gruaja@yahoo.com

ose

me postë mbyllur në një zarf të mbyllur adresën e mëposhtme:

Shoqata "Unë, Gruaja"

Lagja 1, Rr.Rreshit Çollaku, Pogradec

Shënim:

-Zarfi i jashtëm duhet të ketë gjithashtu informacionin:

Aplikimi: **Moderator për Takimet Ndërgjegjësuere**